



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 5450 prot.

Shkodër, më 7.3. 2025

VENDIM

Nr. 13, datë 03.03.2025

“PËR PËRDITËSIM TË VKK BËRDICË NR.29,DATË 06.05.2008 “PËR MIRATIMIN E INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE NË KOMUNEN BËRDICË”, TË MIRATUAR ME VKM NR. 895, DATË 10.11.2010, “PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNES BËRDICË, TË QARKUT TË SHKODRËS”, DHE INVENTARIZIMIN E PASURISË ME NR. 383 VOLUM 1, FAQE 207 ZK 1157”.

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e tij të datës 03.03.2025, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9 pika 1.2, te ligjit Nr. 139, datë, 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të ndryshuar; nenit 3, të ligjit Nr.8744, datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave te paluajtshme publike te shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, VKM Nr. 895, datë 10.11.2010, “Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunes Bërdicë, të Qarkut të Shkodrës”,VKM Nr. 28, datë 27.1.2023 “Për përcaktimin e procedurave të hollësishme të përditësimit të listave të pronave shtetërore dhe rregullave për bashkëpunimin ndërmjet institucioneve VKM Nr.500, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave te paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore” të ndryshuar; VKK Bërdicë Nr.29,datë 06.05.2008 “Për miratimin e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në Komunen Bërdicë”, Udhëzimit Nr.15, datë 30.06.2003, “Për menyrën e paraqitjes nga njesitë e qeverisjes vendore të kerkesave për transferimin në pronesi të tyre të pronave të paluajtshme publike, shkresës Nr.1106/1 datë 19.02.2025 nga Agjencia Shtetërore e Kadastres dhe sipas dokumentacionit të përgatitur nga administrata e Bashkisë Shkodër:

VENDOSI:

1. Të miratojë: Përditësimin e VKK Bërdicë Nr.29, datë 06.05.2008 "Për miratimin e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në Komunen Bërdicë", të miratuar me VKM Nr. 895, datë 10.11.2010, "Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunes Bërdicë, të Qarkut të Shkodrës", dhe inventarizimin e pasurisë me Nr. 383 volum 1, faqe 207, zk 1157 me të dhëna sipas tabelës:

Nr.	Zona Kadastr. & Indeksi i Hartes	Nr. Pasurisë	Lloji i Pasurisë	Emërtesa e pasurisë	Nga Sip.			Funksioni për të cilin përdoret pronë/pasuria	Institucioni me përgjegjësi administrative/pronësi	Institucioni përdorues i pasurisë	Inventarizuar me	Te dhëna të tjera
					Sip. e pasurisë (m2)	Truall (m2)	Ndërtesë (m2)				VKM	(Shënime të veçanta)
	ZK 1157	Nr.383 Vol 1, fq 207	Pa frut	Fusha Sportive Bërdicë e Madhe	6656	-	-	Kulturore Sportive	Bashkia Shkoder	Bashkia Shkoder		

2. Fusha e përdorimit të kësaj pasurie për kryerjen e funksioneve kulturore dhe sportive.

3. Të ndiqen procedurat përkatëse sipas legjislacionin në fuqi, pas miratimit nga Këshilli Bashkiak Shkodër për ndryshimin e pronësisë në favor të Bashkisë Shkodër duke bashkërenduar punën me institucionet përgjegjëse .

4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.


5. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit Nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar.

Miratuar me 36 vota

Vota Pro 36
Vota Kundër 0
Vota Abstenim 0
Zbardhur me datë 04.03.2025

SEKRETARE

Sabina Danaj



Adresa: Rr "13 Dhjetori", Nr.1, Shkodër, web: www.bashkiashkoder.gov.al, e-mail: info@bashkiashkoder.gov.al

KRYETAR

Olton LULLI

